



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Data	
Nr. Prot	

**RELACION PËR PROJEKTVENDIM**

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË PUNËS PËR KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT PËR  
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13 864, datë 24.10.2022, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve pwr organet e qeverisjes vendore", shkronja "gj" e pikës 1 dhe pika 3 të nenit 20, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI**

Referuar nenit 20 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së udhëzuesit dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve.

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13 864, datë 24.10.2022, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve pwr organet e qeverisjes vendore", Komisioni Rregullator mori në shqyrtim udhëzuesin e punës për Komisionet Qendrave të Votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Në referencën ligjore të vendimit janë cituar nenet 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42 dhe neni 43 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të cilat përcaktojnë detyrat e KQV-së, përbërjen, papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së, shkarkimin dhe lirimimin e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së apo detyrat e sekretarit të KQV-së.

**II.PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky udhëzues është një material në ndihmë të Komisioneve të Qendrave të Votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Detyrat e Komisionit të qendrës së votimit (KQV), janë të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në akte të tjera nënligjore të dala në zbatim të kodit. Qëllimi i këtij materiali nuk është përsëritja e parashikimeve të kodit, por në këtë udhëzues janë mbledhur aspektet themelore të funksionimit dhe detyrave të KQV.



Udhëzuesi është hartuar specifikisht për zgjedhjet pwr organet e qeverisjes vendore.

Ky udhëzues iu vjen në ndihmë edhe trajnerëve të administratës zgjedhore për zhvillimin e trajnimeve si dhe Komisioneve të Qendrave të Votimit për funksionimin e tyre dhe administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit . Në këtë material ka informacion mbi përbërjen e KQV, kushtet për emërimin, lirim apo shkarkimin e anëtarit të KQV, mbledhjet e saj, vendimarrja në kushte të zakonshme dhe në kushtet e vakancave të krijuara në KQV.

Në udhëzues janë parashikuar detyra funksionale të KQV, por edhe një informacion shterues lidhur me dokumentacionin e punës që KQV përdor, llojet e vendimeve apo procesverbaleve që KQV plotëson. Për konkretizimin e mënyrës sesi plotësohen modelet e vendimeve apo procesverbaleve materiali ndihmës përmban edhe llojet e vendimeve apo procesverbaleve të plotësuara.

Udhëzuesi shpjegon detyrat dhe veprimet që kryen KQZ një ditë para zgjedhjeve si dhe detyrat dhe veprimet që kryen në ditën e zgjedhjeve. Për një kuptueshmëri më të mirë të udhëzuesit dita e zgjedhjeve është ndarë me rubrika në të cilat janë parashikuar veprime që KQV kryen para hapjes së votimit, procedurën e votimit, mbylljen e votimit dhe veprime që kryen pas mbylljes së votimit.

Udhëzuesi ka parashikuar edhe procedurat që KQV ndjek lidhur me rastet kur pajisja e identifikimit elektronik nuk punon, apo kur kjo pajisje nuk regjistron gjurmët e gishtave të zgjedhësve. Në material janë reflektuar edhe ndryshimet e parashikuara nga Komisioni Rregullator në vendimin nr. 12, datë 24.03.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr.11, datë 25.03.2021, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, të ndryshuar

Ky udhëzues, në pjesën VIII “Rregulla në qendrën e votimit”ka trajtuar personat që lejohen në qendrën e votimit, identifikimin e tyre, si dhe hapësira që zë media e akredituar në një qendër votimi.

Në udhëzues janë parashikuar edhe rastet e veçanta të votimit në të cilën përcaktohet sesi vepron KQV kur paraqitet një zgjedhës që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, apo kur në qendrën e votimit paraqitet një zgjedhës që nuk shikon apo kur paraqitet një zgjedhës me vendim gjykate.

Udhëzuesi ka parashikuar edhe raste që çenojnë procesin zgjedhor si psh në rastin e votimit të për herë të dytë apo paraqitja e një zgjedhësi i paregjistruar në listën e zgjedhësve si dhe raste kur zgjedhësi voton jashtë dhomës së fshehtësisë, dëmton fletën e votimit pa dashje apo fotografon fletën e votimit në dhomën e fshehtësisë si dhe situata që KQV mund të pezullojë votimin dhe të kërkojë ndihmën e policisë së Shtetit për vendosjen e rendit në QV.

Erion Meta – Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Majlinda Çelmeta –Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ –Sekretar i Përgjithshëm





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË PUNËS PËR KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT PËR  
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13 864, datë 24.10.2022, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", të nenit 20, pika 1, shkronja "gj", nenit 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42 dhe nenit 43 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë Udhëzuesin e Punës për Komisionet e Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO – Kryetare**

**Arens ÇELA – Anëtar**

**Dritan ÇAKA – Anëtar**

**Helga VUKAJ – Anëtare**

**Muharrem ÇAKAJ - Anëtar**

Data: dd mm vvvv Nr: ...  
Ora: hh:mm



Për miratimin e udhëzuesit të punës për  
Komisionet e Qendrave të Votimit për  
zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore